Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
Opština Glogovac / Municipality of Gllogoc

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/ Jedinica za/Single Resource Manager

Duke u bazuar në nenet 9, 77, 78, 79, 80 dhe 81 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Rregullores (QRK) - nr. 30/2024 Për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Vendimit Nr.71/VV2026 Date:09.06.2026, Udhëzimi Administrativ MSH nr. 01/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor si dhe Kërkesës Nr.1592 të dt.18.11.2026 së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, NJMBNJ shpallë:

KONKURS

(I jashtëm)

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Numri i referencës: RN00020800

Titulli i vendit të punës: Logoped, Fizioterapeut dhe Punëtor Sociale në Kujdesin Parësor Shëndetësor në QKMF 'Dr.Hafir Shala' Drenas

Institucioni: Komuna e Drenasit/Gllogocit- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF "Dr. Hafir Shala**"** Drenas**.**

Lloji i pozitës: Logoped, Fizioterapeut dhe Punëtor Social

Numri i Pozitave: Tre (3)

- 1 (Një) ***Logoped***
- 1 (Një) **Fizioterapeut**
- 1 (Një) **Punëtor Social**

Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqësit të Drejtëpërdrejt, Drejtorit

Koficienti/paga:H17_6.4 dhe GJ_36- 5.95 Profesional 2 (1 koeficient është rritur me vendim të qeverisë, koeficientët sipas Ligjit nr. 08/l-196 për pagat në sektorin publik është 5.4 dhe 4.95).

Njoftim: 23.11.2026

Afati i aplikimit: 24.11.2026 deri 23.12.2026

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pa caktuar

Periudha provuese: 6 muaj

Orë pune në javë:40

1. **Detyrat dhe Përgjegjësit për Logoped:**

l. Ofron shërbime të vlerësimit të zhvillimit gjuhësor dhe komunikimit te fëmijët0- 6 vjeq, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, përmes instrumenteve të aprovuara nga Ministria e Sh ëndetësisë;
2. Kontribon në zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve Për Familjen (PIShF) per fëmijët te cilët kualifikohen Për shërbime të NFH-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të NFH-së;
3. Ofron shërbime të Ndërhyrjes në Femijërinë e Hershme Për fëmijët 0-6 vjeq në mjediset natyrore të fëmijës, të përqendruara tek familja, të cilat mbështesin, zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë që lidhen me komunikimin pranues dhe ekspresiv, artikulimit gjuhësor, si dhe ushqyerjes/të përtypurit;
4. Monitoron, dokumenton dhe raporton mbi progresin e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e NFH-së, si dhe kontribuon në rishikimin e rregullt të PIShF;
5. Ofron këshilla dhe konsulta të individualizuara prindërve lidhur me mbështetjen e zhvillimit të femijëve 0-6 vjeç;
6. Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimewe, si dhe përfaqësues të institucioneve Për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme;
7. Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

Kriteret e përzgjedhjes

Diplomë universitare në drejtimin Logopedi;
Licencë pune valide nga Oda e Infermierëve të Kosovës;
Përvojë pune në shërbimet e logopedisë, përparësi punë me fëmijët 0-6 vjeç;
Patent shofer valid.
Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

2. **Detyrat dhe Përgjegjësitë për Fizioterapeut**

1.Ofron shërbime të vlerësimit për zhvillimin fizik dhe motorik të fëmijëve 0-6 vjeç, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, përmes udhëzuesit për monitorimin e zhvillimit të fëmijës dhe instrumenteve të tjera të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë;
2.Kontribon n zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve për Familjen (PIShF) Për fëmijët të cilët kualifikohen për shërbime të NFH-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të NFH-së;
3.Ofron shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme Për fëmijët 0-6 vjeç në mjediset natyrore të fëmijës, të pëërqendruara tek familja, të cilat mbështesin, zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë që lidhen me motorikën, koordinimin, balancin, dhe vetëndihmën;
4.Monitoron, dokumenton dhe raporton mbi progresin e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e NFH-së, si dhe kontribuon në rishikimin e rregullt të PIShF;
5.Ofron këshilla dhe konsulta te individualizuara prindërve lidhur me mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeq;
6.Organizon sesione promovuese me prindor, ofrues të shërbimeve, si dhe përfaqësues të institucioneve Për promovimin e programit te Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme;

7.Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

Kriteret e përzgjedhjes

Diplomë universitare në drejtimin Fizioterapi apo Ergoterapi në mungesë të fizioterapeutit;
Licencë Pune valide nga Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës;
Përvojë pune në shërbimet e fizioterapisë, përparësi punë me fëmijët 0-6 vjeç;
Patent shofer valid;
Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

3. <u>Detyrat dhe Përgjegjësit për Punëtor Social</u>

1. Planifikon dhe koordinon punën e ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme (NFH) Për realizimin e vlerësimeve Për fëmijët 0-6 vjeq, duke përfshirë caktimin e anëtarëve të ekipit si dhe bashkëpunimin me familjen Për të përcaktuar kohën e vlerësimeve;
2. Informon familjet lidhur me Shërbimet e NEH-së dhe mënyrat e Ofrimit të këtyre shërbimeve;
3. Koordinon dhe mbështet zhvillimin e Planit të Individualizuar të Shërbimeve Për Familjen (PIShF), duke caktuar Ofruesin primar të shërbimit Për secilën familje dhe duke siguruar që modeli i shërbimit i bazuar në familje dhe i integruar në rutina të fëmijës, reflektohet në PIShF;
4. Shërben Si pikë kontakti Për familjet që marrin shërbime të NFH-së, duke siguruar që familjet i pranojnë shërbimet në përputhje me PIShF;
5. Informon familjen Për shërbimet e disponueshme jashtë institucionit, duke përfshirë referimin tek këto shërbime;
6. Bashkëpunon me shërbimet mjekësore, sociale dhe ato të edukimit Për të Siguruar referimin në kohë të fëmijëve 0-6 vjeq;
7. Kontribon në hartimin e Planit të tranzicionit së bashku me familjen dhe Mjekun familjar respektivisht ofruesin e Shërbimit, Për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve që marrin shërbime te NFH-së në institucionet parashkollore dhe arstmore;
8. Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimeve dhe përfaqësues të institucioneve Për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme;
9. Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes ne Fëmijërinë e Hershme.

Kriteret e përzgjedhjes:

Diplomë universitare në drejtimin punë sociale, sociologji, ose shkenca te tjera sociale;
Licencë valide për shërbime sociale e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë- KPSHSF*;*
Përvojë Pune në shërbimet sociale, përparësi punë me fëmijët 0-6 vjeç;
Patent shofer valid;
Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik (Neni 9 i LZP-së 08/L-197):

1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:
1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës;
1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
1.9 të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fletëaplikacioni i plotësuar;
- Kopja e Diplomës së Fakultetit (e noterizuar);
- Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OMK ose Ministria e Drejtësisë KPSHSF (e noterizuar);
- Jetëshkrimi (CV);
- Kopja e letëmjoftimit apo e pasaportës;
- Kopjen e patent shoferit-valide;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike), ndërsa kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Çertifikata mjekësore (**Pas përzgjedhjes**);
- Dëshmia se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (**Pas përzgjedhjes**);
- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit (**Pas përzgjedhjes**).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (deri 10 pikë)
- Testi më shkrim (deri 70 pikë)
- Intervista me gojë (deri 20 pikë)

Procedurat e konkurimit:

Konkurimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim, të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe dispozitat e Ligjit të Punës, Ligjit për Zyrtarët Publik, dhe të Rregullores (QRK) - nr. 30/ 2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit.

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën për Shërbim me Qytetarë, nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune, në sportelet 10,11,12 në Komunën e Drenasit, aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga web-faqja https://konkursi.rks-gov.net/.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi përmes email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale të noterizuara të kualifikimit që i kanë kryer.

Në rast të mos dorëzimit të dokumentacionit original të noterizuar, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet do te publikohen në portali shtetëror: **https://konkursi.rks-gov.net** si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit https://kk.rks-gov.net/gllogoc/.

Vërejtje:

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.